



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE ✓

Nr. 592

Tiranë, datë 24/01/2017

Drejtuar: Z. PASHK PALOKA
Shoqëria "Malvini" sh.p.k
Lagjia e Xhenios, Rruga e Shëngjinit,

LEZHË

Për njoftim: Z. VIKTOR TUSHAJ, DREJTOR EKZEKUTIV
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto"

TIRANË

Z. ALFRED KALO, DREJTOR I KOMANDUAR
Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
Rruga "Lord Bajron", Laprakë

TIRANË

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1476, datë 23.06.2010.

I nderuar z. Paloka,

Shoqëria "Malvini" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1476, datë 23.06.2010, për gur gëlqeror, pranë fshatit Palatej, në Qarkun Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.2474 Prot, datë 08.03.2016, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1860, datë 10.04.2016, ka ardhur një raport mbi praktikën e dëmshme (në kundërshtim me germën "dh", pika 1, e nenit 47) dhe në kundërshtim me projektin e miratuar që shoqëria "Malvini" sh.p.k përdor në aktivitetin minerar të lejes së shfrytëzimit nr.1476, datë 23.06.2010, për gur gëlqeror, pranë fshatit Palatej, në Qarkun Lezhë

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994 "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, që është shfuqizuar me ligjin nr.10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1476 datë 23.06.2010, për gur gëlqeror, pranë fshatit Palatej, në Qarkun Lezhë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.1476, datë 23.06.2010, për gur gëlqeror, pranë fshatit Palatej, në Qarkun Lezhë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

Në mungesë dhe me porosi

Zv. Ministri

ILIR BEJTJA

